



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË LEPOSAVIQIT PËR VITIN 2024

Prishtinë, qershor 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Leposaviqit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Leposaviqit (Leposaviq), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Leposaviqit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Mos regjistrimi dhe mos raportimi i pasurive kapitale dhe jokapitale në PFV për vitin 2024, në vlerë totale prej: 2,792,221€.
- B2 Mos raportim i llogarive të arkëtueshme, rrjedhimisht Komuna nuk ka raportuar vlera financiare për vitin 2024 dhe vitet krahasuese (2023 dhe 2022).

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Leposaviqit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- B3 Mos zbatimi i ligjeve për mbledhjen e të hyrave (tatimi në pronë, leje ndërtimit, dhe dhënies në shfrytëzim të pronës publike).
- B4 Angazhimi i zyrtarëve administrative pa procedur adekuate të rekrutimit.
- B5 Mungesa e plotë e dëshmimeve për vijueshmëri në punë.
- B6 Mos themelimi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm.
- A1 Vonesa në pagesën e faturave dhe shpenzime tjera shtesë për pagesat e ekzekutuara nga thesari.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Leposaviqit .

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Leposaviqit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Leposaviqit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Leposaviqit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislati i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Leposaviqit .
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë procesit të auditimit, kemi identifikuar disa fusha ku mund të përmirësohet performanca duke përfshirë kontrollin e brendshëm. Testet tona kanë treguar që nevojiten përmirësime në raportimin e pasurive jo financiare, prezantimin e llogarive të arkëtueshme në PFV, zbatimin e ligjit për për tatimin në pronë/leje ndërtimi dhe dhënies në shfrytëzim të pronës publike, angazhimin e punonjësve për shërbime të veçanta konform procedurave ligjore, vijueshmëria e plotë në punë e stafit, funksionimin e auditimit të brendshëm dhe ekzekutimi i pagesave të faturave brenda afateve kohore, të cilat janë paraqitur me poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Raporti i auditimit ka rezultuar me një (1) rekomandim të ri dhe gjashtë (6) rekomandime të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Mos regjistrimi dhe mos raportimi i pasurive kapitale dhe jokapitale në PFV

Gjetja Rregullorja nr. 02/2013 "Për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore", neni 6, përcakton se; pasuria kapitale duhet të regjistrohet në Sistemin Informativ të Menaxhimit të Financiar të Kosovës (SIMFK), ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin "e-pasuria".

Gjatë rishikimit analitik të PFV kemi vërejtur se Komuna nuk ka raportuar pasuri kapitale, jokapitale dhe stoqet edhe për kundër që gjatë vitit 2024 kishte realizim të pagesave në vlerë 8,541€ (duke mos përfshirë pagesën e vendimeve gjyqësore në vlerë 16,925€) dhe viteve paraprake (2022 dhe 2021) ka realizuar pagesa për shpenzimet kapitale shumë prej: 1,530,702€ dhe 1,252,978€, që në total shuma e pa regjistruar është 2,792,221€.

Shkaku i mosregjistrimit të pasurive ishte mungesa e zyrtarëve përgjegjës për regjistrimin e pasurive në regjistrat përkatës kontabël.

Ndikimi Mos regjistrimi i pasurisë kapitale dhe jokapitale në regjistrat përkatës të pasurive jo financiare, ndikon në prezantim jo të drejt dhe të plotë të pasurive në PFV.

Rekomandimi B1 Kryetari, duhet të ndërmerr masa për krijimin e regjistrave të pasurive mbi dhe nën 1,000€ duke regjistruar të gjitha pasuritë që ka në posedim në mënyrë që prezantimi i informatave në PFV të jetë i saktë dhe i plotë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Mos raportim i llogarive të arkëtueshme

Gjetja Rregullore nr. 01/2017 Për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore - Neni 16, përcakton se; OB që mbledhin të hyra janë të detyruara të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumave të faturuara e të pa arkëtuara. Të arkëtueshmet shpalosen në raportin vjetor financiar në tabelën përkatëse sipas llojit të hyrave.

Gjatë rishikimit analitik të PFV kemi vërejtur se komuna nuk ka raportuar shumë e llogarive të arkëtueshme për vitin 2024 si dhe dy viteve paraprake krahasuese.

Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së stafit.

Ndikimi Prezantimi jo i plotë i llogarive të arkëtueshme reflekton me informata jo të plota dhe të sakta për menaxhmentin dhe lexuesit e PFV-ve.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të forcojë kontrollet dhe të përmirësojë proceset e regjistrimit dhe raportimit financiar për të siguruar që të gjitha të dhënat në PFV të jenë plota dhe të sakta.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja B3 - Mos zbatimi i ligjeve për mbledhjen e të hyrave (tatimi në pronë, leje ndërtimit, dhe dhënies në shfrytëzim të pronës publike)

Gjetja Ligji nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, neni 12 përcakton se; çdo organizatë buxhetore duhet të mbledhë të hyrat nga tatimi në pronë.
Gjithashtu edhe ligji nr. 04/L-110 për ndërtimet në nenet 16 dhe 27 ka përcaktuar qëllimin e lëshimit të lejeve ndërtimore. Ligji nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës, rregullon mënyrën dhe përcakton procedurat dhe format për dhënien në shfrytëzim të pronës.

Komuna ende nuk ka vendosur politika të zbatimit të ligjeve, rregulloreve dhe nuk ka ndërmarrë veprime konkrete për arkëtimin e të hyrave nga këto veprimtari që kanë ndikim të rëndësishëm në nivelin e buxhetit të komunës dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Gjithashtu, bazuar në PFV kjo po ndikon për shkak të komplikimeve që kanë të bëjnë me librat kadastralë, si dhe mungesa e stafit rrjedhojë e situatës në krijuar në Komunë.

Ndikimi Mos zbatimi i ligjeve për mbledhjen e tatimit në pronë, taksave për leje të ndërtimit dhe të taksave e tarifave tjera nga ana e komunës, pasqyron një qasje joserioze për të aplikuar kërkesat ligjore në këtë fushë. Kjo rritë rrezikun e pa pajtueshmërisë me ligjet e aplikueshme dhe redukton nivelin e të hyrave vetjake, si dhe mundësinë e financimit të projekteve nga ky burim i të hyrave.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të siguroj zbatimin e ligjeve për mbledhjen e të hyrave ,që kanë për qëllim në radhë të parë zbatimin e kërkesave ligjore si dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës. Njëherit duhet të inicioj pa vonesë hartimin e një rregullore të brendshme për taksat, tarifat dhe ngarkesat e qytetarëve për shërbimet e përfituara publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Angazhimi i zyrtarëve administrative pa procedur adekuate**Gjetja**

Rregullorja nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, neni 57 Procedura e prokurimit për shërbimet e veçanta, pika 57.1 potencon se; Qëllimi i këtij neni është që në kuadër të kësaj rregullore të definohet hapat të cilët duhet të ndiqen për udhëheqjen e një procedurës për sigurim të Konsulentëve / Kontraktoreve Individual për Shërbimeve të veçanta. Rrjedhimisht, pika 57.3 Shërbimet e veçanta të cilat nuk mund të sigurohen përmes procedurave të rekrutimit janë shërbime profesionale për të cilat Autoriteti Kontraktues ka nevojë por të cilat shërbime nuk mund t'i plotësojë me stafin që ka, po ashtu pika 57.4 Konsulenti / Kontraktori individual është një specialist në një fushë specifike, i angazhuar nga Autoritet Kontraktues në rolin e një këshilluesi.

Nderlidhur me këtë neni 57.7- Kontraktimi i Konsulentëve Individual bëhet përmes procedurave të prokurimit, kontratë publike për shërbime me kriter të shpërbimit "Tenderi ekonomikisht me i favorshëm". në varësi të vlerës se parashikuar, Autoritet Kontraktues përcakton afatet kohore për dorëzim të tenderëve, siç përkufizohet në nenin 44 të LPP-së.

Gjatë testimit të pagesave në tri (3) raste kemi vërejtur se Komuna ka angazhuar zyrtar administrative sipas kontratës së punës dhe detyrave specifike duke përcaktuar pagën bruto prej 420€ për secilin zyrtarë duke mos zbatuar procedurat e prokurimit.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos zhvillimit të procedurave të prokurimit me qëllim zëvendësimit e mungesës së stafit.

Ndikimi

Dobësitë e identifikuar mund të rezultojnë me mungesë të mirëfilltë të konkurrencës dhe cilësi të dobët të shërbimeve të ofruara.

Rekomandimi B4

Kryetari duhet të sigurojë që në angazhimet e zyrtareve administrative - stafit profesional, të respektohen procedurat ligjore si dhe të marrë masa të duhura në mënyrë që raste të tilla të mos përsëriten në të ardhmen.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B5 - Mungesa e plotë e dëshmive për vijueshmëri në punë****Gjetja**

Rregullorja 04/2024 për orarin e punës, pushimet dhe vijueshmërinë e zyrtarëve publikë, neni 17 përcakton se; Zyrtari publik është i obliguar që të regjistrohet në regjistrin elektronik të vijueshmërisë.

Komuna përdorë evidencë për të punësuarit për vajtje/ardhje në punë në të cilat nënshkruhen të gjithë punonjësit për ta dëshmuar prezencën e tyre në punë por gjatë rishikimit tonë kemi vërejtur se nuk ishin evidentuar stafi në lista.

Komuna e Leposaviqit përdor evidencën fizike për vijueshmërinë në punë, përmes listave ditore ku punonjësit nënshkruhen për të dëshmuar prezencën e tyre por gjatë vitit 2024 nuk na janë ofruar dëshmi për evidentimin e punonjësve. Gjithashtu, edhe pse në muajin dhjetor është instaluar pajisja elektronike për monitorimin e vijueshmërisë, ajo ende nuk është funksionale. Arsyja është se një pjesë e zyrtarëve nuk posedojnë

ID-të elektronike që i identifikojnë si punonjës të Komunës, çka e pamundëson përdorimin efektiv të këtij sistemi.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos funksionimit të kontrolleve të brendshme nga ana e zyrtarëve përgjegjës për këtë fushë.

Ndikimi

Mungesa e evidencave për prezencën në punë të të gjithë stafit, paraqet kontroll të dobët mbi menaxhimin e stafit dhe mundësi për pagesën e parregullt apo fiktive, të zyrtarëve që nuk respektojnë orarin e punës.

Rekomandimi B5

Kryetari duhet të sigurojë ndërmarrjen e masat e nevojshme për të siguruar se zyrtarët nënshkruhen apo evidentohen në listën e vijueshmërisë apo regjistrin elektronikë, përndryshe kjo situatë paraqet shkelje disiplinore, në pamundësi të kontrollit të prezencës së këtyre zyrtarëve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B6 - Mos themelimi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm

Gjetja

Rregullorja QRK nr. 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit publik, neni 5 përcakton se; çdo subjekti i sektorit publik me buxhet mbi tre (3) milion euro themelon Njësinë e Auditimit të Brendshëm, e cila duhet të ketë se paku dy auditor.

Komuna gjatë vitit 2024, nuk kishte ndërmarrë veprime për Themelimin e Auditimit të Brendshëm.

Kjo ka ndodhur për shkak të mospriorizimit të këtij funksioni në strukturën organizative dhe buxhetore të Komunës.

Ndikimi

Mos themelimi i NjAB-së, përveç së është në kundërshtim me kërkesat ligjore i pamundëson menaxhmentit marrjen e veprimeve për parandalimin e gabimeve të mundshme në kohë sa me të hershme.

Rekomandimi B6

Kryetari duhet të sigurojë marrjen veprime për themelimin dhe plotësimin e NJAB-së me staf të mjaftueshëm që direkt ndikon në forcimin e kontrolleve të brendshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A1 - Vonesa në pagesën e faturave dhe shpenzime tjera shtesë për pagesat e ekzekutuara nga thesari

Gjetja

Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi (LMFPP) nr. 03/L-048 neni 39.1 përcakton se; çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbime e funrizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës.

Po ashtu neni 40.3 i Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit parash "Pas pranimit të vendimit të plotfuqishëm ose urdhrit të formës së prerë, Ministria është e autorizuar dhe ka përgjegjësinë që menjëherë të marrë çfarëdo masa të nevojshme për pagimin e vendimit ose urdhrit nga ndarjet buxhetore në dispozicion; me kusht që nëse vendimi i plotfuqishëm është nxjerrë kundër një komune, vetëm përvetësimet e komunës mund të shfrytëzohen për përmbarimin e këtij vendimi".

Gjatë testimit është konstatuar se janë realizuar dy pagesa përmes

procedurave përmbartimore/gjyqësore, konkretisht një pagesë në vlerë prej 12,538€ dhe një tjetër në vlerë prej 4,387€, me një shumë të përgjithshme prej 16,925€, të cilat janë ekzekutuar nga Thesari. Përdorimi i kësaj forme të ekzekutimit të pagesave ka rezultuar në rritje të shpenzimeve për procedura përmbartimore, në vlerë prej 925€.

Hyrja në obligime është si shkak i kontraktimeve pa pasur buxhet të mjaftueshëm dhe mos përgjegjësisë së zyrtarëve përgjegjës ka ndikuar në mosrealizimin e pagesave brenda afatit kohorë ligjor që ka rezultuar më pagesën e tyre përmes vendimeve gjyqësore/përmbartimore më shpenzime shtesë për procedurat përmbartimore.

Ndikimi

Si pasojë e vonesave në pagesa dobësohet aftësia e komunës për të parashikuar dhe menaxhuar likuiditetin e saj nga vendimet përmbartimore përmes thesarit ka ndikim direkt në rritjen e kostos për komunën.

Rekomandimi A1

Kryetari duhet të sigurojë që obligimet të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen brenda afateve kohore ligjore me qëllim që mos të dëmtohet buxheti i komunës me kosto shtesë të përmbartimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezentuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondeve	5,832,216	2,755,209	1,613,178	961,978	3,990,526
Grante Qeveritare - Buxheti	5,735,231	2,516,682	1,566,678	961,978	3,888,534
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	0	48,192
Të bartura nga viti i kaluar	0	119,400	36,900	0	125
Të hyrat vetanake	96,985	96,985	9,600	0	30,866
Donacionet e jashtme	0	22,142	0	0	22,809

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte ulur për 3,077,007€. Kjo ulje është rezultat i ndryshimeve në përkrahjen nga grantet qeveritare në vitin 2024, rritje ka pasur si rezultat i të hyrave të bartura nga viti i kaluar dhe donacioneve të jashtme.

Në vitin 2024, janë shpenzuar 58.55% e buxhetit final ose 1,613,178€. me një rënie 31% krahasuar me vitin 2023.

Se si ishte realizuar buxheti sipas kategorive janë dhënë shpjegimet në tabelën në vijim.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	5,832,216	2,755,209	1,613,178	961,978	3,990,526
Pagat dhe mëditjet	2,561,461	827,982	822,508	452,321	1,956,642
Mallrat dhe shërbimet	500,000	499,480	485,979	90,247	369,292
Komunalitë	120,000	11,452	11,125	0	64,000
Subvencionet dhe transferet	120,000	357,836	268,100	419,410	69,891
Investimet Kapitale	2,530,755	1,058,459	25,466	0	1,530,702

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar është ulur për 3,077,007€. Kjo ulje është rezultat kryesisht Vendimeve të Qeverisë në emer të kursimeve buxhetore.

Shpenzimet kryesore janë realizuar në këto kategori:

- Buxheti final për paga dhe mëditje, krahasuar me buxhetin fillestar, është ulur për 1,733,479€. Shpenzimet në këtë kategori janë realizuar në 99.3% të buxhetit final dhe përbëjnë 50.98% të shpenzimeve totale për vitin 2024. Krahasuar me vitin 2023, ato janë rritur me afër 81.9%, gjë që reflekton rritjen e numrit të të punësuarve.


-Buxheti final për mallra dhe shërbime, krahasuar me buxhetin fillestar, është ulur për 520€. Shpenzimet për këtë kategori kanë arritur në 97.3% të buxhetit final dhe përbëjnë 30.13% të shpenzimeve të përgjithshme për vitin 2024. Krahasuar me vitin paraprak, ato janë rritur me 438.4%.

-Buxheti final për komunalitë, krahasuar me buxhetin fillestar, është ulur për 108,548€. Kjo kategori është realizuar në 97.1% të buxhetit final dhe përbën 0.69% të shpenzimeve të përgjithshme për vitin 2024. Krahasuar me vitin 2023, kjo kategori ka një rritje të lehtë prej 2.9%.

-Buxheti final për subvencionet dhe transferet, krahasuar me buxhetin fillestar, është rritur për 237,836€. Shpenzimet janë realizuar në 74.9% të buxhetit final dhe përbëjnë 16.61% të totalit të shpenzimeve për vitin 2024. Megjithëse ka një ulje prej 36.1% krahasuar me vitin 2023.

-Buxheti final për investimet kapitale, krahasuar me buxhetin fillestar, është ulur për 1,472,296€. Shpenzimet për këtë kategori janë realizuar në vetëm 2.4% të buxhetit final, që përbën një realizim jashtëzakonisht të ulët, respektivisht 1.58% të shpenzimeve totale për vitin 2024. Krahasuar me vitin 2023, ka një ulje drastike prej 90%, dhe shkak është mungesa e stafit.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Të hyrat e realizuara në vitin 2024 ishin në vlerë 10,465€, të gjitha nga burime jo tatimore si: taksa nga çertifikatat dhe të ngjashme. Në këtë vit, të hyrat janë rritur ndjeshëm krahasuar me vitin 2023 (rreth 1107%), por mbeten ende të ulëta krahasuar me potencialin e Komunës.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
Totali i të hyrave	96,985	96,985	10,465	867	2,045
Të hyrat jo tatimore	96,985	96,985	10,465	867	2,045

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare (PFV-të) për vitin 2023 të Komuna e Leptosaviqit (KL) ka identifikuar gjashtë (6) rekomandime për të përmirësuar efikasitetin dhe proceset. KL ka zhvilluar një plan veprimi për të adresuar këto rekomandime në mënyrë të detajuar.

Gjatë periudhës së auditimit për vitin 2024, gjashtë (6) nga rekomandimet nuk janë zbatuar. Për të dhënë një shpjegim më të detajuar të çdo rekomandimi dhe si janë trajtuar ato, ju lutemi referohuni tabelës 4 në vijim.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari, duhet të ndërmerr masa për krijimin e regjistrave të pasurive mbidhe nën 1,000€ duke regjistruar të gjitha pasuritë që ka në posedim në mënyrë që prezantimi i informatave në PFV të jetë i saktë dhe i plotë.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për ta korigjuar këtë çështje.	Nuk ka filluar zbatimi
2.	Baza për opinion	Kryetari duhet të forcojë kontrollet dhe të përmirësojë proceset e regjistrimit dhe raportimit financiar për të siguruar që të gjitha të dhënat në PVF të jenë plotë dhe të sakta.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për ta korigjuar këtë çështje.	Nuk ka filluar zbatimi
3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të siguroj zbatimin e ligjeve për mbledhjen e të hyrave ,që kanë për qëllim në radhë të parë zbatimin e kërkesave ligjore si dhëritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës. Njëherit duhet të inicioj pa vonesë hartimin e një rregullore të brendshme për taksat, tarifatat dhe ngarkesat e qytetarëve për shërbimet e përfituara publike.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për ta korigjuar këtë çështje.	Nuk ka filluar zbatimi
4.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që në angazhimet e zyrtareve administrative - stafit profesional, të respektohen procedurat ligjore si dhe të marrë masa të duhura në mënyrë që raste të tilla të mos përsëriten në të ardhmen.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për ta korigjuar këtë çështje.	Nuk ka filluar zbatimi
5.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë ndërmarrjen e masat e nevojshme për të siguruar se zyrtarët nënshkruhen apo evidentohen në listën e vijueshmërisë apo regjistrin elektronikë, përndryshe kjo situatë paraqet shkelje disiplinore, në pamundësi të kontrollit të prezencës së këtyre zyrtarëve.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për ta korigjuar këtë çështje.	Nuk ka filluar zbatimi
6.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë marrjen veprime për themelimin dhe plotësimin e NJAB-së me staf të mjaftueshëm që direkt ndikonë në forcimin e kontrollit të brendshme.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për ta korigjuar këtë çështje.	Nuk ka filluar zbatimi

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme





Lavdim Maxhuni, Drejtor i Auditimit



Grup i Operatorëve Ekonomik "AlbAudit" SH.P.K. & "ProAudit" SH.P.K.
(Hajdar Hoxhaj, person i autorizuar në emër të grupit)



Shtojca I: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Leposaviqit / Opština Leposaviq / Municipality of Leposaviq

LETËR E KONFIRMIMIT


Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve


Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Leposaviqit, për vitin 2024 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe (kjo pikë përshatet nga entiteti)
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. LULZIM HETEMI
Pozita: (Kryetar i Komunës)
Data: 04.Maj.2025
Nënshkrimi: 



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.